



Mbledhje konsultuese e KKD-së



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko zhvilloi takimin e parë me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës në Dyseldorf, Gjermani, një takim ky i mundësuar nga anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Lazim Destani. Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Majko foli për rëndësinë që ka pasur formimi i Këshillit Koordinues të Diasporës, si një strukturë, e cila funksionon për herë të parë në shtetin shqiptar. Kjo strukturë është ngritur për krijimin e një bashkëpunimi më të afërt mes institucioneve shqiptare dhe komuniteteve në Diasporë për t'u njozur me problematikat e tyre dhe për t'u ofruar mbështetje. Ndërsa organizatori i këtij takimi z. Lazim Destani në fjalën e tij e cilësoi si shumë të rëndësishëm këtë takim të parë të KKD-së, ku janë bashkuar njerëz të përzgjedhur nga Diaspora, të cilët për vite me radhë kanë dhënë kontributin e tyre në promovimin e vlerave dhe interesave të kombit, duke qenë ambasadorët më të mirë të trojeve shqiptare. "Dëshiroj që ky takim, i këtij formati, për gjeneratat e reja të jetë shembull se si mund të arrihet koordinimi dhe bashkëpunimi më i mirë mes diasporës dhe institucioneve shtetërore në trojet tona", u shpreh ai.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Firmoset marrëveshja me UNESCO-n



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko firmosi një Memorandum Mirëkuptimi me z. Jaagz Bajaj, përfaqësues i Fondacionit për Politikë Diplomatike dhe Kërkim Shkencor (DRPF) si dhe ekspert i UNESCO-s për Shqipërinë. Firmosja e këtij memorandumit ka një rëndësi të veçantë për forcimin e marrëdhënieve mes palëve në lidhje me realizimin e një arsimit sa më cilësor, promovimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor si dhe krijimin e një programi për arsimin në gjuhën shqipe që do t'u vijë në ndihmë komuniteteve shqiptare në Diasporë për të promovuar gjuhën dhe kulturën shqiptare.


"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



Çdo qytetar shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, tanimë ka mundësi të adresojë shqetësimin e tij drejtpërdrejt në të gjitha nivelet drejtuese të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kjo falë rubrikës më të re "Raporto", e cila sapo është shtuar në platformën Ambasadalme.

- Për përdoruesit e iOS aplikacioni shkarkohet [këtu](#);
- Për përdoruesit e Android aplikacioni shkarkohet [këtu](#);

Miratohet vendimi për ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të FSHZHD-së



Këshilli i Ministrave miratoi ndryshimin e Vendimit 594, të datës 9.10.2018, "Për emërimin e Kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës". Sipas këtij vendimi, znj. Dajna Sorensen, e cila do të jetë edhe Kryetare e Këshillit Drejtues të FSHZHD-së, zëvendëson z. Elton Haxhi, përfaqësues nga Ministria e Financave. Gjithashtu znj. Mira Hoxha emërohet si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme në vend të z. Andris Stastoli. Këshilli Drejtues i FSHZHD-së është një organ vendimmarrës për çështjet financiare, organizative dhe administrative të FSHZHD-së, në përbushje të detyrave dhe funksioneve të tij.

Foto e ditës



Pas përfundimit të takimit me anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, ku u diskutua për statutin e këtij këshilli.

KKD, Holandë / Ardian Lekaj investon në Shqipëri



Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, Ardian Lekaj dhe vëllai i tij Alzan Lekaj investojnë në vendlindje. Prej vitesh të mirintegruar në shoqërinë holandeze, së fundmi ata kanë ardhur në Shqipëri për të hapur një biznes lulesh, në komunën e Bërxullës, duke sjellë përvojën holandeze në Shqipëri. Qëllimi i hapjes së biznesit është krijimi i vendeve të reja të punës për banorët e kësaj komune.

Itali / Shkollat e gjuhës shqipe marrin tekste falas nga QBD-ja



Të tjera shkolla të gjuhës shqipe në Itali pajisen me tekste mësimore shpërndarë falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me MPEJ-në. Shkollat shqipe në komunat Orsonja dhe Tollo, të Italisë kanë marrë tashmë tekstet e mësimin plotësues të gjuhës shqipe, sipas kërkesës së tyre. Gjithashtu edhe Federata e Shoqatave Shqiptare "FAAI" në Itali është pajisur me tekstet shkollore për mësimin e gjuhës shqipe. Në fillim të muajit shtator Qendra e Botimeve për Diasporën mundësoi dërgimin e teksteve shkollore për mësimin e gjuhës shqipe në 12 shtete.

Kroaci / Nis mësimi me tekstet falas nga QBD-ja



Qendra më e re kulturore "Shtëpia Shqiptare e Kulturës", e hapur pak ditë më parë në qytetin e Karlovacit, Kroaci, është pajisur tashmë me abetaret dhe librat për mësimin e gjuhës shqipe, të shpërndara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Greqi / Nis mësimi me tekstet falas nga QBD-ja



Organizata "Jeta" në Greqi, dega Selanik, ka organizuar orën e parë të gjuhës shqipe "Mësojmë shqip në Selanik" me tekstet shkollore të dërguara posaçërisht nga Qendra e Botimeve për Diasporën, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Sloveni / Nis mësimi me tekstet falas nga QBD-ja



Nxënësit shqiptarë në Lubjanë të Sllovenisë fillojnë mësimin plotësues në gjuhën shqipe me tekstet e dërguara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Postën Shqiptare dhe nën kujdesin e Ministrisë të Shtetit për Diasporën. Shoqata kulturore shqiptare "Migjeni" në Lubjanë i ka tërhequr tekstet në Ambasadën Shqiptare në Slloveni.